



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

P R O C E S V E R B A L

I M B L E D H J E S S Ë N J Ë M B D H J E T T Ë R R E G U L L T T Ë K U V E N D I T T Ë K O M U N Ë S S Ë V I T I S Ë

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më datë **26.12.2019, (e Enjte)**, në Sallen e Kuvendit Komunal të Vitisë, në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10h. Në mbledhje morën pjesë: nënkryetari, z.Hasan Aliu, kryesuesi i Kuvendit, z.Naim Pira, si dhe këshilltarët e Kuvendit Basri Sylejmani, Zejnepe Osmani, Valbona Haziri, Ramadan Deliu, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Taibe Ibrahimimi, Zekirja Zuka, Nijazi Isaku, Jakup Demiri, Sejdi Emini, Mirlinda Sadiku, Liridona Bislimi, Remzi Salihu, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Blerina Lubishtani, Samet Idriizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Valentina Hasani, Vehbi Rama, Rasim Terziqi, Besim Ymeri. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, zyrtarja për barazi gjinore, mjetet elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 27 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e njëmbëdhjetë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Me lejoni që të ju përsëjndes të gjithëve të pranishmit, me lejoni të ju uroj për këtë ambient të ri në këtë sall të kuvendit. Jemi në fund të vitit, ju uroj festat e fundvitit, me dëshirën që vitin 2020 të jetë një vit i shëndetshëm. MAPL-ja nuk naj ka konfirmu ligjshmërinë e akteve ende, po ne konsiderojmë që janë të ligjshme. Tani kalojmë tek pyetjet jashtë rendit të ditës.

znj.Idajete Pira: Përsëjndetje të nderuar të pranishëm! Po me intereson ta di që a ka bënë komuna listën e pronave private si dhe listën e pronave publike që jepen në shfrytëzim, pasi që këto nuk i kam pa që janë publiku ne wëp faqe. Renovimet e objekteve të komunës që janë bënë te objekti ku ka qenë kryetari në Zyrën e Kryetarit dhe në Zyrën e Tatimit të Pronës, a janë regjistru inventari dhe ku janë dërguar ato, se sipas informacioneve që kam ato janë hudhur në mesin e arave.

znj.Mirlinda Sadiku: Përsëjndetje të nderuar të pranishëm! Uroj që të jetë një vit i mbarë 2020-ta, urime edhe festat e fund vitit. Kam një pyetje. Rregullorja që ka qenë për rregullimin e orarit të bizneseve, i ka kry procedurat e diskutimit publik me 09.08.2019, ka qen në diskutim publik, a është problemi që nuk është funksionalizu qeveria e nuk keni marr përgjigje nga MAPL-ja, apo çka është problemi që nuk është kthy në kuvend. Kam pyetje për drejtoreshën e Arsimit. Procesi i bursave, konkursi ka qenë me datën 14.11.2019, ku ka mrri si proces si dhe pse nuk ka konkurs për sekretar të shkollës tek Gjimnazi, për arsye se ka pas shumë kërkesa nga drejtorët e arsimit lidhur me përvojën e punës. E dinë se për çka e ka fjalën. E kam edhe një pyetje, ndoshta nënkryetari përgjigjet, më intereson ta di renovimi i infrastrukturës mbrojtëse përgjatë lumit “Morava e Binçes” dhe në Viti me nr. të prokurimit 657183949511, me sa para ka participu komuna, kur e dimë që është një projekt

trevjeçar dhe kosto e këtij projekti është 1 milion e 98 mijë euro. Prandaj me intereson sa ka participu komuna këtu.

z.Nijazi Isaku: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Po më intereson, disa kontrata a janë mbyll dhe a është bërë pranimi teknik i punëve. P.sh.: kontrata “ndërtimi i parkut industrial” në Budrikë, në vlerën prej 200 e 19 mijë euro, është nënshkruar kontrata në shtatorin e vitit 2017, afati i përfundimi ka qenë 12 muaj. Në disa dokumente që janë prezantuar në këtë kontratë, e keni cilësuar si projekt 2 vjeçar. Pyetja është, a është përmbyll kontrata dhe a është bërë pranimi teknik i punëve, ndërsa kontrata “zgjerimi i rrugës Drobesh deri te rruga e Mogillës”, në vlerën prej 341 mijë euro. Kjo kontratë është nënshkruar dhjetorin e vitit 2017, afati kohor ka qenë 14 muaj, por nuk po ndalemi te afati, se edhe këtu ka tejkalim të afatit, por pyetja është a është përmbyll kjo kontratë dhe a është bërë pranimi teknik i punëve të kryera, ndërsa pyetje për DKRS-në, pasi kemi investuar në pamjen e jashtme të shtëpisë së kulturës “Gursel e Bajram Sylejmani”, ku e keni izoluar nga jashtë, por qysh është e mundur që salla madhe është pa nxemje. Këtë po e themë, se të dielën u dashtë qytetarët e komunës sonë me shkuar në Gjilan për një shfaqje të organizuar nga çerdhja e fëmijëve “Hello”, ku ne si prind u dashtë me i dërguar fëmijët në Gjilan për mungesë të nxemjes në sallën e madhe. E kam edhe një pyetje për Drejtorinë e Arsimit, lidhur me formimin e shkollës për arsim profesional për të rritur, ku ne kemi ngritur si çështje me një seancë, ku ka qenë e gjetur në raportin e auditorit të jashtëm, rrjedhimisht kanë qenë tri shkelje ligjore sipas auditorit të jashtëm. Pyetja, a keni ndërmarr ndonjë masë lidhur me këto shkelje.

z.Bekim Azizi: Sot do të kyçem prapë aty ku e lamë në seancën e kaluar. Dëgjoj edhe nëpërmjet mjeteve të informimit, që është anuluar konkursi për edukatore mbështetëse që ka pas për shkollën në Smirë. Ka mbi tre muaj që nxënësit nuk mbajnë mësim për shkak se mësimdhënësja vetëm se ka ndërruar jetë dhe nuk ka asnjë lajmërim në faqe zyrtare që është anuluar konkursi. Mirëpo, konkursi është anuluar me pretekstin, kinse nuk ka buxhet. Kjo është e pabazume, kjo është një mashtrim. E dyta, anulimi i konkursit i të gjithë atyre që kanë thanë që është anuluar konkursi, ju është thanë, konkursi është anuluar se është bërë presion nga Bekimi, përkatësisht nga unë. Nëse është anuluar për atë po më vjen mirë, sepse po e kuptoj se me të vërtetë keni bërë shkelje të ligjit. Mirëpo unë mendoj se në Smirë është dashtë patjetër të zgjidhet edukatorja, sepse diku 30 fëmijë janë duke ndejtur në shtëpi. Çështja tjetër që e kisha ngrit është një problem që kohët e fundit, një dukuri, në shkollën e mesme teknike në Viti janë shfaq veshjet me shami të tri nxënësve të cilët vijojnë procesin mësimor dhe ky proces është hesht nga drejtori i shkollës dhe nga DKA-ja, një dukuri nuk e di sa është e lejuar me ligj. Kisha pyetje, a janë të drejtë a nuk kanë të drejtë? Sepse unë mendoj se deri në fund të vitit kjo dukuri do të jetë shumë e përhapur në shkollë, një përkrahje shumë të madhe kanë edhe nga do mësimdhënës, besoj se në këtë temë edhe nënkryetari mund të kyqet. Tjetra, kemi ngrit një problem të një asfaltimi të një rruge deri te varrezat në Smirë, diku 300 metra, është tash e dimi, dimrit është problem të shkojmë atje të bëhet varrimi, është edhe vendi i ramjes së tre dëshmoreve. Me fillim vit është premtuar, kemi biseduar në këtë sallë, jemi marr vesh të bëhet ai asfaltim para dy muaje, kemi diskutuar prap, na u dha një zotim se do të kryhet dhe s’keni marr asnjë hap sa i përket kësaj.

z.Taulant Haxhiu: Desha një informatë rreth renovimit të shtëpisë së kulturës, që është bërë komplet, nuk e di shumë saktë, po po dëgjoj se ka pak keqpërdorime në këtë projekt. Kisha kërkuar prej personit kompetent të më jep një informatë për këtë, unë po e shoh këtu kur është rinovuar, shikone atë pjesë menjëherë ka filluar të prishet. Unë nuk besoj se kryesuesi Pira dhe nënkryetari Aliu në shtëpinë e vetë e kishin lejuar ashtu.

znj.Liridona Bislimi: Sa i përket pyetjeve, po i drejtohem Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Më intereson me ditë se sa është e furnizuara Qendra e Mjekësisë Familjare me barna esenciale. Na intereson ta dimë, pasi në fund të vitit kërkesat e qytetareve janë ma të shpeshta dhe ma të nevojshme. Dhe për Drejtorinë e Arsimit kam një pyetje, si shpjegohet nga ana juaj para qytetarit e kam fjalën për shkollën fillore “Halil Alidema”

në Pozheran, sipas jush deri kur nxënësit do të detyrohen të mësojnë në këto kushte me orar të shkurtuar dhe me klasa të stërbushura së bashku me shkollën tjetër “Kongresi i Manastirit”. Gjithashtu edhe tema e konkursit, edhe ne si lëvizje shprehim shqetësim për konkursin që është shpallur me datë 25.11.2019. Nuk e di çfarë arsytimi ka të shpallet konkursi dhe të anulohet dhe të jepet shpjegim se nuk ka mjete financiare për këto pozita. Në qytetin e Vitisë po qarkullojnë zëra se vendi në Smirë vetëm se është i premtuar për një familjare të një militanti të LDK-së. Tash nuk pres përgjigje për këtë pyetje, vetëm se janë duke e pritur deri sa ta përfundon fakultetit dhe të ju shpallet vendi i punës.

z.Sejdi Emini: Edhe unë sot kam disa kërkesa, por edhe pyetje. Së pari po ndalem me ambulanten e Pozheranit, atje fare nuk ka autoambulant, e cila është emergjente me qenë së paku një, nëse janë dy, njëra mu ndal në Viti e njëra në Pozheran. Më ka rastisë me qenë afër një aksidenti që ka ndodh dhe kam parë se është vonuar mbi 1 orë deri sa u ardhur. Po ashtu sa kam informata drejtor i Shëndetësisë, në Pozheran disa dritare nuk janë funksionale, është mirë mu merr me to, por edhe nexhja qendrore nuk funksionon. E dyta, në qendër në Viti ka disa rrugë që paraqesin rreziqe serioze. Njëra ndër to është edhe rruga për Pozheran. Aty është e domosdoshme ose me u bë një rreth ose nëse nuk ka mundësi të rrethit së paku me i bë do semafor funksional, se përndryshe aksidentet nuk kanë me na u ndal kurrë, po edhe te stacioni i autobusëve me shku në mbrëmje me shikuar çfarë kaosi po u bëjke. Unë kisha propozua aty me i bërë dy barriera si janë nëpër do qytete, me hypë makinat mbi të dy metra të gjata, një në hyrje dhe një në dalje dhe krijohet siguri për nxënësit. Rruga “Elena Gjika”, qytetarët kanë prit se këtë vit do të përfundoj, tash kanë marr informata se nuk po kryeke këtë vit. Tash qytetarët janë të zhgënjyer dhe presin përgjigje nga ju. Rrugë që donë tretuar rrugë që paraqet rrezik është edhe rruga e fshatit Gushicë, ajo rrugë nuk ka asnjë milimetër tretuar për këmbësor. E kam ngrit edhe më herët po e ngris edhe sot, nëse bëhet vonë ka me pas ndonjë fatalitet edhe që nuk është larg mendsh, atëherë përgjegjësinë mbane ju edhe mos hajde me pa askënd atje se ka ndodh ajo.

z.Remzi Salihu: Unë kisha një pyetje për kryetarin, por pasi që ai nuk është po ju drejtohem drejtoreshës së Arsimit. Çka është ndërmarr lidhur me pagesën e punonjësve arsimor rrethe pagës jubilarë, pagesave për mëditje dhe për rrugë. Mesa e di, ne kemi ngritur këtë problem disa herë, por tash shpesh herë na është thanë se na mungon buxheti ose unë isha me thanë ma mirë mungon vullneti dhe mënyra e shpërndarjes së pagesës, sepse shumica për mos me thanë të gjithë janë në proces të bërjes së padisë së komunës pikërisht për këtë fenomen. Prandaj, nëse gjykata vendos në të mirë të këtyre ankesave, ku do ti merrni paret komuna, apo përmbaruesi nuk e pyet komunën fare. Mendoj që do të komplikohet më shumë situata kur kemi pas mundësi që këto gjëra t’i rregullojmë me marrëveshje me mirëkuptim, ato nuk kanë ardh në shprehje. Pyetjen tjetër do ta kisha ndërlidh me pyetjen paraprake që kam bë në seancën e kalume, rreth deponive në fshatin Reminik dhe Skifteraj. Çka është ndërmarr rreth këtyre deponive, a janë konstatu, a janë evidentu apo çka është marr për këto?

znj.Fatbardha Emini Drejtoresh: Përsëritje të nderuar të pranishëm! U parashtruan disa pyetje, po filloj nga e para lidhur me bursat, ku ka përfunduar konkursi, siç e dini tash janë në procedurat e vlerësimit nga ana e komisionit. Besoj që dikun në tremujorin e par të vitit që vjen do të bursohen fituesit e bursave. Sekretari i shkollës së Mesme “Kuvendi i Lezhës”, kjo pozitë është shërbyes civil dhe Ligji mbi Shërbimin Civil është pezullu përkohësisht për arsye që është ne sektorin publik. Ne i kemi parashtrur kërkesë Zyrës së Personelit, e cila i ka anuluar të gjitha konkurset që lidhen me shërbyesit civil. Ke një pyetje për evidentimin e pronave komunale, me që kam qenë unë drejtoresh, atje ka qenë një projekt i DEMOS-it, ku kemi qenë përfitues dhe janë kry të gjitha evidentimet e pronave komunale dhe jemi njëra ndër komunat e para që e kemi databazën e pronës komunale. Unë e di që është publiku ne wëp të komunës, e ndoshta u ndryshu versioni i wëp faqes. Zbatimi i rekomandimeve të auditorit për mësimin jo formal, ka qenë një e gjetur e auditorit për mësimin jo formal në shkollën profesionale “Januz Zejnullahu”. E dini që mësimi joformal në këtë shkollë është organizu që nga viti

2004 dhe procedurat e organizimit janë zhvillu të njëjta ashtu siç e zhvillojnë edhe komunat tjera, po aty një rekomandim ka qenë, se disa shkolla profesionale janë të akredituara dhe këtu ka qenë një keqkuptim, sepse shkolla profesionale e Vitisë është në procedurë të akreditimit dhe disa shkolla e kanë të përfunduar akreditimin, se përndryshe deri sa të sqarohet të gjitha këto, ne i kemi pezullu organizimin e mësimi jo formal, kemi marr vitin e kaluar një vendim si drejtori dhe e kemi pezullu për vitin shkollor 2018-2019, siç e dini nuk ka organizim të mësimi jo formal deri sa të qartësohen të gjitha procedurat ligjore që eventualisht mos të bëjmë ndonjë shkelje pa qellim apo me qellim në vijim. Anulimi i konkursit të fundit, i cili është ngrit edhe në seancën e kalume nga Bekimi, nuk është bë prej presioni. Ky anulim po ka ardh për shkak se jemi në vij të 825 punëtorë që janë në sistem. Ato njihen edhe pushimet e lehonisë dhe ndonjëherë ne e dimë që ato vendet e pushimeve të lehonisë ku 25 pozita na merren prej pushimit të lehonisë dhe kështu që vendimin e fundit që e kemi marr për alukimin e mjeteve, ministria nuk e ka aprovuar Ministria e Financave, kështu që jemi kanë në ministri sa për njoftim, që këtë muaj dy mësimdhënës kanë mbet jashtë sistemi, e për këtë e kemi shty që konkursin me shpall në janar. Pagat jubilarë është një sfidë edhe për Komunën e Vitisë, edhe për të gjitha komunat përjashtim prej komunës së Prishtinës, është kontrata kolektive e qeveris së kalume e cila është bë në kohën e fushatës. Ajo kontratë kolektive nuk është që ne nuk po dojmë me e zbatu, po ministria e linjës, Ministria e Financave, siç e dini shëndetësia dhe arsimit janë fonde prej grandit specifik. Ne gjithëherë kur të bëjmë planifikime financiare, ne i planifikojmë se nga kontrata kolektive dalin edhe këto obligime, po Ministria e Financave asnjëherë nuk qet mjete. Tani prej 2019 ka fillu me i bart mjete prej tri pagave përcjellëse. Ne prej 2019 jemi tu i pagu tri pagat përcjellëse ne momentin e pensionimit. Ne më përpara nuk i kemi pagu pagat përcjellëse që dalin prej kontratës kolektive, ne jemi tu bë presion me kolegjiunin e drejtorëve të arsimit në nivel të vendit edhe me Ministrinë e Financave, e duhet ata disi ja duhet me e anulë atë kontratë ja duhet me ju bë mjete komunave, se përndryshe përmbaruesi vitin e ardhshëm apo mas një viti mas së paku vetëm prej pagave jubilarë 500 mijë euro kanë me shku shpenzime Komunës së Vitisë. Edhe një pyetje që e ngriti Beka, është një çështje e ndjeshme, nuk është e definuar mirë në aspektin ligjor, për shkak se njëherë anë e drejta e shkollimit është e garantume me kushtetutë dhe me ligje në anën tjetër në të gjitha shkollat si ne Gjilan - Ferizaj po ka nxënës të kësaj natyre kam marr njoftim nga drejtori dhe disa mësimdhënës, duhet t'i shikojmë anët ligjore, sepse kanjëher tu mundu me zbatu një parim mundesh me e dëmtua dikan në aspektin e shkollimit. Është kriju kjo edhe në Kuvendin e Kosovës, kemi deputete që janë me shamija, kemi në universitet, në arsimin e mesëm, fillore kemi edhe në Parlament të Evropës deputete me shami, e ne jemi tu e shqyrtu këtë rast që e kemi në shkollën tonë.

z.Ibrahim Rama, drejtor i financave: Përhëndetej të nderuar të pranishëm! Pata disa pyetje lidhur me inventarin në Komunë të Vitisë. Ne i kemi formu komisionet që janë tu e bë inventarizimin e të gjithë inventarit, edhe këtë në vitin që e kemi në funksion tash të rritjes së objekteve dhe inventarin që ka qenë ekzistues. Pra, komisionet janë tu e kry këtë punë. Na kanë ardh informata edhe prej arsimit dhe shëndetësisë, që ka inventar të papërdorshëm dhe që i uzurpon hapësirat, i pengon hapësirat në shfrytëzim që dy thirrje i kemi bë publike përmes Zyrës së Prokurimit, për mi shit këto inventar që nuk është i përdorshëm. Me ju thanë të drejtën, që dy herë kurrkush nuk lajmërohet dhe njëherë e kemi provu, tash nëse nuk realizohet kjo ide, na duhet të marrmi masa ligjore që është asgjesimi. Duhet të formohet një komision komunal. Mirlinda bëri pyetje për lumin “Morava”, a është projekt i Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë. Është një projekt, është në ekzekutim e sipër, është projekt trevjeçar, kështu që është në përfundim të pjesës së parë të financave, që janë kanë të planifikuara me buxhet të ministrisë. Janë kry punët dhe në vazhdim ta shohim. Unë besoj që jo komuna nuk participon, është komplet investim i ministrisë përkatëse. Parku industrial është pjesa e dytë e tenderimit që është duke ekzekutuar. Pjesa e parë është kry ne vitin 2018, tash është projekti i ri që është operatori i ri, vlera e projektit është 1 milion e 800 mijë, është projekt dyvjeçar që financohet nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë,

ne e monitorojmë ekzekutimin e projektit, po kryesisht pagesa dhe buxheti është në ministrinë përkatëse, kurse sa i përket rrugës edhe kjo është investim i nivelit qendror, Ministrisë së Infrastrukturës, projekti i rrugës Mogillë-Drobesh, nuk është bë pranimi teknik, nuk është kry sipas projektit të gjitha punët që janë kanë të parapamë, pardje është nënshkru edhe një aneks marrëveshje me Ministrinë e Infrastrukturës, për me i përfundu të gjitha ato punë që janë të planifikuar me marrëveshjen e parë. Pra, pardje është nënshkru marrëveshja, unë besoj që edhe kjo rrugë do ta merr kompletimin në vitin në vijim. Aneksi ka kosto dikun 150 mijë euro. Rruga e varrezave, e kam këtë informatë në Smirë, unë besoj që në projektin në vijim kemi me shti në planifikim dhe me e kry këtë rrugë me asfaltu. Zyra e Projekteve është tu e bë, projektin për vitin 2020, fondin buxhetor e keni miratu ju, pra unë besoj që do të shtrohet edhe kjo rrugë. Renovimi i shtëpisë së kulturës, gjithashtu nuk është bë pranimi teknik. Taulanti e pat fjalën për këtë ambientin e sallës se renovimin i shtëpisë së kulturës. Është një projekt tjetër, kurse ky i sallës se kuvendit komunal është projekt që ka të bëj në kuadër të renovimit të komunës. Këtu në këtë projekt janë tri hapësira: kuvendi komunal kjo sallë, komuna e vjetër ku kemi punu deri tash dhe atje ku ka qen tatimi në pronë, dhe të tri këto objekte janë me një projekt që është thënë renovimi i Komunës së Vitisë dhe nuk ka përfundua në total për kualitetin. Tash po e shohim të gjithë deri në pranimin teknik të këtij projekti ne do t'i adresojmë vërejtjet e juaja. Rruga “Elena Gjika”, asfaltimi i kësaj rruge është në projekt, është me buxhet të caktuar, po projekti i asfaltimit të rrugëve rurale është projekt dyvjeçar që për këtë vit sa kemi pas buxhet i kemi kry asfaltimin e rrugëve rurale, kurse rrugën “Elena Gjika” e kemi lan me fillimin e vitit të ardhshëm kur të alokohet buxheti dhe fillojnë punët ne teren. Unë besoj që edhe kjo rregullohet.

z.Basri Aliu Drejtor i shëndetësisë: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Ishte një pyetje si shqetësim, i cili është shqetësim edhe për ne, sepse prej listës esenciale çdoherë kemi të përfshimë 100%, por në mungesë pasi që është kompetencë e Ministrisë së Shëndetësisë. Ne kur kemi mungesë të barnave esenciale, atëherë edhe intervenojmë me buxhet komunal, kështu që, nuk është gjendja për mu shqetësu deri në atë pikë po 100% asnjëherë nuk mundem ta realizojmë. Sejda e përmendi për një autoambulancë në Pozharan. Ky shqetësim është edhe i joni, po mundësitë janë diçka tjetër. Na jemi tu e shqyrtu këtë mundësi, është e nevojshme se Komuna e Vitisë e vetmja komunë është që i bart në dy qendra për ka 24 orë, që punojnë përveç Komunës së Vitisë nuk e ki asnjë komunë që i mban 24 orë, prandaj na jemi tu e shqyrtu mundin po edhe sa për informim me 30 shpresojmë pasi që Ministria e Shëndetësisë me kërkesën tonë që e kemi bë e kemi përfitu një autoambulancë që me 30, do ta sjellim në Viti. Sa i përket nxemjes ne kemi edhe menaxherin këtu të ambulantes në Pozharan. Ne kemi bisedu, kemi kontakt, gjendja nuk është aq alarmante, ka defekte, je tu e shqyrtu mundësinë, formën për me e zgjedh këtë problem. E sa i përket dritareve, punë e vogël, duhet me drejtoreshën e cila është menaxher, do ta shohim nëse është naj defekt i vogël.

z.Milot Lala, drejtor për Kulturë: Përshëndetje të nderur të pranishëm! Sa i përket pyetjes, se çështjes së nxemjes në objektin e kulturës, nxemja sa i përket renovimit, nuk ka qenë e parapamë tërësisht, ka qen pjesërisht edhe kompania ingjenjeric e ka shti në funksion. Po, kuptohet se sistemi i vjetër ka qenë, ka pas avari, ka punu nxemja në 2019 pjesërisht, tash për momentin është jashtë funksionit dhe na e kemi parapa që për vitin 2020 me e rregullu. E sa i përket çerdhes “Hallo”, nuk ka shku në Gjilan për shkak të xemjes, sepse e kemi edhe nxemjen alternative, po kuptohet se çerdhja “Hello” është prej Gjilani dhe i ka konvenu më shumë që aktivitetet me i mbajt në Gjilan, kurse të Diellen një dit me herët Premten i ka mbajt provat këtu te objekti i shtëpisë së kulturës.

z.Nexhmedin Jakupi, drejtori i shërbimeve publike: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! U përmenden çështjet e një deponie të krijuar ne fshatin Remnik dhe Skifeteraj. Unë a kam pas edhe një takim me Liridonën, këshilltaren, unë isha në vendin e ngjarjes, atje ishte një prock rreth kodrës së pristojes, dikune 400-500 metra larg fshatit. Me keqardhje duhet me pranë faktin, se nuk është e vetmja deponi në komunën tonë, po kemi shumë deponi të ngjashme. Ne edhe vitin e kaluar si komunë jemi marr seriozisht me eliminimin e deponive ilegale në

tërë territorin e Komunës së Vitisë. Dikun edhe vitin e kaluar po edhe këtë vit mbi 60 deponi ilegale i kemi eliminua. Fatmirësisht sivjet e kemi pas edhe një donacion nga ministria, të cilin e kemi fitu si grandin e preferencës, e kemi bë edhe një projekt që është në proces tani elimini i këtyre disa prej këtyre deponimeve ilegale të krijuar të cilat qysh në Pranverë sektori i mjedisit i ka bë evidentimin së bashku me inspektorin e ambientit edhe tani është tu realizu në bazë qati projekti. Ne edhe këtë deponi dhe shumë të tjera që janë në territorin e komunës tonë. Me keqardhje po duhet me pranu faktin, se nuk jemi tu angazhu të gjithë si shoqëri, duhet edhe qytetarët mu angazhu edhe ju këshilltarët me e shfrytëzu ndikimin a juaj tek qytetarët, tek familjet që nuk paguajnë, nuk janë në sistem të pagesës për shërbimin që e ofron kompania, pasi që edhe në Remnik është një operator që vjen dhe i merr mbeturinat, mirëpo tash operatori nuk po i detyron me dhunë me pagu për shërbimin që i ofron. Është mirë me fol të gjithë me qytetarët.

z.Hasan Aliu nënkryetar i komunës: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Drejtorët u përgjigjen në pyetjet, por ne disa pyetje po përgjigjem edhe unë. Sa i përket pyetjes së regjistrimi të pronave, të gjitha pronat janë të regjistruar. A ka gabime në regjistrime për shkak të mungesës së shënimeve kur është bë databaza, ka, pronë pa emërtim nuk ka. Njazia e tha, përkundër investimeve shumë të mëdhaja, turp për Vitin. Nuk shkojnë edhe investimet e mdhaja edhe turpi. Nuk është turp mos me punu nxemja, ndodhë kjo na po jetojmë në Kosovë ndodhin defekte, më vjen keq për ata fëmijë. U cek përfundimi i shkollës “Halil Alidema”, projekti ka qenë dyvjeçar, u kanë dashtë me përfundu sivjet, për shkak disave atje në ministri ja kishin shty planin dinamik atij, përkundër presionit të madh që i kemi bë vazhdimisht, nuk e di sa ja kanë zgjat planin dinamik. Kërku atje te rruga Pozharan-Viti, të kryqi i rrugës. Në atë planin e mobilitetit, është e parapamë mu bë një ishtull aty, megjithatë unë konsideroj që vitin e ardhshëm do ta kemi këtë, ndërsa tek stacioni ato që u kërkuan konsideroj që duhet me fol me drejtorin e inspeksionit, gjegjësisht me inspektorin e komunikacionit, se çka ata parashohin dhe çka i rregullon rregullativa ligjore e komunikacionit. Sa i përket trotuarit Goshicë-Germovë, është një prej kërkesave, po kemi edhe shume lokalitete të cilat janë në atë gjendje, e janë lokalitete më të mëdhaja. Duhet me qenë parimor Remzia, vjen prej Remnikut së bashku me mu, jemi lokalitet me i madh me banorë dhe nuk e kemi trotuarin qyshe po e kërkon ti Sejd, as unë nuk jam kundër asaj, jam të presim me radh vendet që janë me të frekutuuar, që ka nxënës më shumë. U kërkua rregullorja për çështjen e biznesit pas debateve që i kanë mbajt janë ka i shqyrtojnë ato vërejtje të cilat me i inkurporu me siguri në seancën e janarit si tekst i kompletuar duhet me ardh për aprovim.

z.Bekim Azizi: Drejtoresh, unë nuk kërkova as largim të nxënësve nga procesi mësimor, unë pyeta si është e rregullume në aspektin ligjor për shkak se është bë bajagi shumë debat dhe është diskutu kjo çështje, mirëpo po ju rikujtoj që praktika të tilla ka pas në Viti. Nëse nuk e di ka pas në gjimnazin “Kuvendi i Lezhes” dhe ka pas procedura që kanë hec nëpër gjykata deri ne gjykatën kushtetuese dhe vendimi i gjykatës kushtetuese tregon që Kosova është vend laik. Numri i referencës është rk137/11, i datës 30 Shtator 2011. Vendim i gjykatës kushtetuese që tregon se në bazë të ligjeve ne fuqi, praktik e gjykatës kushtetuese që i tejkalojnë normat, rregullat e shkollës, sepse arsimiti i mesëm nuk është i obligueshëm, është fakultativ, shkruhet në atë vendim të gjykatës kushtetuese dhe ne faqen e 13 të këtij vendimi e ka dhënë përshkrimi, gjykata kushtetuese. Ju kisha kërkua ta përcjellin këtë vendim. Te konkurset që janë anulë, po e lamë që është qashtu siç po thu ti, po parimisht, mjerisht të gjitha konkurset që po i bëni në momentin që shpallen konkurset edhe na po e dimi se kush vjen po i dimi krejt ato marrëveshjet se për kanë po hapet vendi i punës, se konkursi kur po qelet në Komunë dijet saktësisht se për kanë. Drejtor i financave, sa i përket punëve që janë bë këtu në këtë sallë, po shifet puna askush nuk e kish leju këtë pune mu bë.

z.Nijazi Isaku: Te çështja e kësaj kontratës që janë shtu, përveç 34 mije euro edhe 150 mije euro tjera, për mu kjo është skandaloze se a ndodh ne at kompani a ka pas naj far mase që është ndërmarr a ka pas pranim teknik

apo mos funksionim ose nuk është përgjigj ne ato kërkesat që i ka pas në bazë të kontratës. Cilat janë veprimet që i ka marr komuna për me i ndëshku at kompani apo është bë një shpërblim shtesë edhe nja 150 mijë euro, kur e dimë na se krejt banojmë në komunën tonë dhe e dimë se çfarë rruge. Çka është bë aty, nuk janë as 5-6 km asfalt, ku 4 centimetra riasfaltim i atyre rrugëve edhe prej xhamisë plus ajo pjesë te rruga e Pozharanit, kur e dimë aty çfarë luhatje e bën kerri, e tash plus ekstra edhe 150 mije euro. Unë mendoj që këtu ka diçka realisht edhe për këtë nuk ka as pranim teknik, se unë kam mëndu këtë lënde me qu në prokurori edhe me dal me e verifiku, po tash nuk paska pranim teknik, paska edhe një pjesë tjetër të kontratës që është bë. Te çështja e shamisë se nxënësve në shkolla, mendoj që nuk është pengesë.

z.Taulant Haxhiu: Unë thash që po e shohim ne krejt këtë se çfarë pune është bë në këtë sallë, që është një punë katastrof, e ti thu që sa serioze kur krejt po e shohim. Sa i përket ingjizimit që e kam publiku ne facebook, ay shihet qartë se ti e ke pranë një dështim të komunës mu me ki pëlqye për sinqeritetin tanë, po ndoshta të ka bërtit ai Kimjogu e këtu ki thanë joserioze.

Kryesuesi z. Naim Pira: Për rendin e ditës për seancën e XI të rregullt të Kuvendit, kemi:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dhjetë e KK-së.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndërrimin e destinimit të parcelave të propozuara me nr.2582-6 dhe nr. 2582-8 nga shfrytëzimi aktual tokë tjetër - jo pjellore në rrugë publik.
3. Propozim vendim për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim Kompanisë për distribuim dhe furnizim me Energji Elektrike (KEDS), pa procedurë konkurrimi.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Planin e punës së KKSB-së për vitin 2020.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Planin e punës së zyrtares për Barazi Gjinore.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Planin komunal për Integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019-2022.
7. Informatë (Raport) për zbatimin e Planit të Integritetit për Komunën e Vitisë.
8. Informatë (Raport) për realizimin e planit të punës së KKSB-së për vitin 2019.
9. Raport analitik i buxhetimit të përgjithshëm gjinor për vitin 2019 dhe planifikimi për vitin 2020.

Kryesuesi z.Naim Pira: Unë po i qes në votim për miratim rendin e ditës. Kush është pro, a ka kundër? Nuk ka. Konstatoj që me votat e të gjithëve u miratu rendi i ditës. Me kërkesën e komandantit të Stacionit Policor të Vitisë, unë ju kisha lut që pikën e 8 të rendit të ditës, Informatë (Raport) për realizimin e planit të punës së KKSB-së për vitin 2019, ta qesim pikë të parë të rendit të ditës, pasi që komandanti e ka një agjent tjetër. A kishim mujt me vendos si pikë të parë. Me votat e të gjithëve u vendos që kjo të jetë pikë e parë e rendit të ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

1. **Informatë (Raport) për realizimin e planit të punës së KKSB-së për vitin 2019**

znj.Ibadete Hyseni: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Bazuar në planin e punës së KKSB-së për vitin 2019, kemi hartuar një raport për realizimin e objektivave të përcaktuara me këtë plan, ku janë ndërmarr një ser aktivitetesh, si mbajtja e forumeve të sigurisë, projektet e ndryshme të realizuara për eliminimin e dukurive negative si dhe aktivitete tjera. Materialin e keni marr me kohë, për pyetje shtesë jemi ne dispozicion anëtarët e KKSB-së. Gjithashtu është prezent edhe komandanti i policisë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Nuredin Lutfiu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Një pyetje e kam për Komandantin e Policisë, një shqetësim i qytetarëve. Ka zëra që flasin për përdorimin e lendeve norkotike nëpër shkollat e Komunës se Vitisë,

me theks të veçantë në shkollat e mesme. Ju si stacion i policisë, a keni informacione për këtë shqetësim të qytetarëve.

znj.Mirlinda Sadiku: Vitia ka pas një trend të thyerjeve të shtëpive, sidomos këto të cilat janë të mërgimtarëve. Më intereson ta di, cili është trendi këtë vit dhe sa ka mujt policia me qenë aktive në zbulimin e rasteve. Nuk e di a është diskutu ndonjëherë me këtë ekip, se Vitia nuk ka kamera vëzhguese të cilat do të ja lehtësonin juve punën që do të na ndihmon neve në parashikim të buxhetit. Po ashtu tek siguria e nxënësve në trafik. Kemi pas aprovu një plan të mobilitetit, i cili në letër ka qenë shumë i mirë, po në praktik po ngec. Flas me kompetencë të plotë. Ishmi në vizit te shkolla “Halil Alidema” për me i pa dëmet që janë shkaktu nga tërmeti. Aty nuk ka zebra, vetëm është një shej e trafikut, po nuk ka zebra që paralajmëron, d.m.th vozitësit në shkollë. Njëjtë është gjendja edhe në fshatin Skifteraj. Janë të rrezikuar sidomos fëmijët që janë parashkollor. Aty vozitet me një shpejtësi jashtëzakonisht të madhe. Prandaj, kërkoj që sidomos tek shkolla te vendosen zebra të cilat reflektojnë, se komuna ka një buxhet që i përdor për pajisjet e trafikut, mirëpo më shumë po i jepet rendësi në Komunën e Vitisë se sa në fshatra përreth. Kjo vlen tek pika 10, zgjidhja e problematikes se geneve endacak në rrugë. Asnjëherë si komunë, ani pse e ka obligim ligjor, të jeni të bindur se edhe fëmija im ka qenë i atakuar prej qenve endacak. Fatmirësisht kam qëllu aty, e sidomos këtë kohë kur kemi d.m.th prehen posterrmat dhe e dimë se si hedhen gjërat që mbesin. Prandaj, sinqerisht tek shkolla në fshatin Skifteraj, fëmijët janë të rrezikur prej geneve endacak. Mos thashtë Zoti me na ndodh një rast. Unë për këtë problematik flas që katër vite, po nuk ka pas reflektim nga qeverisja komunale. Për narkotikët, po flas në aspektin e përgjithshëm. Sipas një hulumtimi të cilin e ka bë një organizatë joqeveritare, që merret me lëndët narkotike dhe rehabilitimin e të rinjve, sipas atij hulumtimi, rezulton se përdorues me të mëdhenj në Kosovë dhe që është trendi në rritje, dikun 15%, d.m.th 5 mijë fëmijë brenda vitit aty rezulton se me së shumti janë të atakuar 15-16 vjeçar. Unë e di që kemi polic me rroba civile dhe janë në kryerje të detyrës gjithmonë, po sinqerisht këto shifra na bëjnë me u brengos edhe ne si prind dhe si pjesë e kësaj shoqërie. Cilat janë raportet, a ka hapësirë për mu shqetësu edhe pse Kosova vend transit, po megjithatë diçka po mbetet anash.

z.Nijazi Isaku: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Edhe unë pajtohem me parafolësit për çështje të norkotikëve në shkolla, që besoj që krejt pajtohem që është një shqetësim i madh, i jashtëzakonshëm. Kur ki parasysh që është e ardhmja e këtij vendi. Janë rinia dhe ataki me i madh po ju bëhet pikërisht rinisë dhe mendoj që ju si stacion, si Polici e Kosovës keni një rol të jashtëzakonshëm, meqenëse edhe keni aparatit e dhunës në kuptimin që edhe masat që duhet me i ndërmarr. Kjo si pyetje, a ka masa që i keni ndërmarr, a ka dënime për shpërndarësit e drogave. A keni naj informacion, a ka marr ndonjë veprim gjykata, a ka denu dikan prej shpërndarësve të narkotikëve? Edhe një pyetje tjetër komandant, te çështja e prerjes së pyjeve, edhe kjo është shqetësuese, ku e dimë krejt, se sa prehet pyjet, çfarë dëme ju kanë shkaktu pyjeve tona. E di që kjo është në harmoni edhe me drejtorin e pylltarisë, mirëpo edhe ju si polici masat apo dënimet që i keni shqiptu lidhje me prerësit e maleve.

z.Bekim Azizi: Duke pas parasysh që policia është një ndër faktorët kryesor të ruajtjes së sigurisë së njerëzve dhe ne e dimë që viti që shkoj ka qen një vit me tragjik, për shkak të aksidenteve në komunikacion. Sa keni mujt, ose cilat janë informatat që po lidhen me aksidentet që po bëhen, cilat janë shkaktaret kryesor të aksidenteve dhe cilat masa janë ato që janë ndërmarr, a janë adresu si kritikë ose si kërkesë te institucionet komunale që të përmirësohen? Nëse është faktori në komunë që ka mundësi të bëjnë investim, që t'i orientoj investimet kapitale në atë pjesë, sepse ne e dimë që në komunikacion bëhen bejagi shumë investime, mirëpo të qohen ato investime në ngritjen e sigurisë në komunikacion. Dhe një çështje tjetër që duhna ta ngris, përdorimi i armeve, sidomos tashti është koha e festave të fund vitit, që është një rrezik për qytetarët. Po ashtu edhe përdorimi i armëve gjatë festave të dasmave, janë dy elementet kryesore që kemi pas viktima gjatë këtij viti.

z.Afrim Halili Komandant i Stacionit Policor në Viti: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! I mirëpritja pyetjet. z.Nueredini, për dukuritë negative, është shqetësim nëse kemi vetëm një përdorues, është shqetësim apo nëse kemi edhe një shpërndarës këtu në Viti, është shqetësim. Kemi dukuri negative të narkotikëve që zhvillohen,

kemi raste që paraqiten raste që kapen në flagrancë, mirëpo është pak më pak se ai perceptimi i përgjithshëm. Ju kisha lut që mos të bimë pre e perceptimeve, se rinia po e përdorin të gjithë, apo se ka shpërndarje masive. Policia është në aktivitet kryesorë. Një nder preventivat kryesore që i bëjmë ne, i bëjmë te parandalimi i narkotikëve, për këtë arsye në vazhdimësi ne e kemi një plan operativ i cili është stop drogave dhe është duke vazhdu. Për këtë arsye ne kemi polic në rroba civile të shkollat, po kemi edhe shumë pjesëtar tjerë tonë që angazhohen, po kemi edhe njësinë të nivelit rajonal dhe ati qendror. Të gjitha masat që merre për t'i parandalu këta e bëjnë parandalimin. Tërësisht nuk e bëjnë, mirëpo luftimin jemi duke e bë bashkërisht me qytetarët tanë që na përkrahin shumë. Në këtë aspekt, me përkrahjen që e kemi edhe nga punëtorët e arsimit, që i falënderoj shumë, po bëjmë një punë të madhe. Vetëm ne si viti që i kemi regjistru, i kemi mbi 25 raste që janë kap të shpërndarësve, zakonisht janë me pakicë, nuk janë sasi të mëdhaja, po si shpërndarës, ndërsa dukuria e përdorimi, ajo është shumë shqetësuese, sepse nëse kemi përdorues në familje, është shumë e dëmshme, e rrezikshme. Kështu, në këtë aspekt jemi të pakompromis, po gjithmonë duke kërku dhe falënderu qytetarët për ndihmën. Kemi pas edhe fushatën vitëdijësuese, senzibilizuese, kemi majtë ligjërata nëpër shkolla, duke i shpjegu, duke u mundu me ndiku te nxënësit dhe besoj që një masë një punë të mirë e kemi bë, po mbetet shumë për të bë edhe vitin e ardhshëm, sepse nuk e kemi përfundu me këtë dukuri. Kjo do të na përcjell edhe vitet në vijim. Tek pyetja e Mirlindës, thyerjet e shtëpive apo vjedhjet e renda ne i quajmë, krahasuar me vitin e kaluar kemi pas pak më pak, gjithsej janë vjedhje të rënda 50. Në këto 50 vjedhje përfshihen shtëpitë, po përfshihen edhe vjedhjet e imta, po për shkak të natyrës se si janë kry, që janë kry, nuk do me thanë që janë të gjitha vjedhje të shtëpive. Nuk është numër i madh, prej këtyre një pjesë e madhe janë zbardh dhe do të zbardhen në vazhdimësi. Nuk ka qenë shqetësues problemi i vjedhjeve dhe vjedhjeve të rënda. Këtë vit, pasi që nuk kemi pas ngritje nga viti i kalum po kemi pas stagnim, e dikun edhe ramje, ndërsa të zbulushmëria kemi qenë mirë. Raporti jonë vjetor do t'i prezanton të gjitha besoj që do të keni informata për raportin tonë. Projektin e kamerave, e kemi projektin e gatshëm i cili projekt është përpiluar nga ana e policisë. Ky projekt i është dorëzuar komunës. Komuna është zotuar se do ta financoj ose do të gjej donator. Jemi në fazën e bisedimeve me disa donator, unë besoj që shumë shpejt do ta kemi edhe sistemin e kamerave në Viti. Kanë bë shumë qytete tjera sistemin e kamerave, teknologjia ndihmon në parandalimin e veprave penale, ndihmon në zbardhjen, mirëpo edhe kufizimin e sjelljeve devijante të njerëzve nëpër vendet ku monitorojnë me kamera. Siguria në trafik, sidomos tek shkollat, kemi polic që bëjnë siguri atje, sidomos kur u përmend shkolla "Halil Alidema", aty çdo mëngjes e kemi policinë. Kemi polici tek stacioni i autobusëve këtu në Viti, kemi polic te shkollat e mesme në Viti dhe mbetet shumë, po ne kemi bisedu me zyrtarët komunal, që t'i bëjmë shenjëzimet e ndryshme për t'i marr masat që të investojmë në rrugë, sidomos të udhëkryqi i Pozharanit që u cek këtu. Aty vetëm e kemi diskutu, këto janë projekte që do të bëhen në të ardhmen. Te qentë endacak. Këtu nuk kemi zgjidhje të lehtë, jemi në diskutime, jemi tu e ngrit këtë çështje, po ajo e mira klasike e eliminimit të qeneve endacak nuk lejohet me ligj, ndërsa format e tjera kushtojnë dhe do të kemi edhe investitor dhe buxhet kështu, që mbetet në të ardhme me bë diçka. Nijaziu bëni pyetje për masat që i kemi ndërmarr tek prerja e pyjeve, dënimet janë çështje të gjykatës, po të jeni të bindur që ka dënime po nuk na kënaqin neve ato dënime, po bëhen në suaza të normave ligjore. Prerja e pyjeve, është një dukuri shqetësuese edhe kjo dukuri luftohet, është Agjensioni i Pyjeve, policia asiston saherë që kemi kërkesa nuk është punë primare e policisë që merrmi vetëm drejtpërdrejt me ta, mirëpo gjatë qarkullimit të druve ilegale ne i konfiskojmë ato dhe i dorëzojmë në objektet e Agjencionit të Pyjeve të Kosovës. Bekimi pat pyetje për aksidentet me fatalitet, aksidentet në përgjithësi. Ka qen shqetësuese këtë vit nëse i referohemi numrit të aksidenteve me dëme materiale që ne i mëngojmë si stacion. Këtë aspekt kemi pas ulje të aksidenteve, kemi pas nga 75 që kemi pas vitin e kaluar, këtë vit i kemi 53 aksidente me dëme me të lënduar, gjithashtu kemi ulje dikun 15-20%, kemi ulje me të lënduar, po fatkeqësisht aksidente me fatalitet këtë vit kemi pas shumë me shumë se vitin e shkuar. I kemi pas 6 aksidente me fatalitet me 7 të vdekur, që kjo gjendje nuk është e pranueshme, nuk është e lejueshme, kemi ndërmarr masa dhe në tre muajt e fundit kemi ramje drastike të aksidenteve edhe me dëme edhe me lëndime dhe me fatalitet. Te përdorimi i armeve të zjarrit. Përdormi i armeve të zjarrit është vepër penale e dënueshme. Kjo

dukuri është duke shkuar në ulje të përdorimit të armeve të zjarrit në krahasim me vitet e kaluara, ndërsa konfiskimi i armeve të zjarrit nga ana e policisë është në rritje çdo vit e sipër. Besoj që masat që i kemi ndërmarr kanë ndikuar në këtë shpresë dhe bëj apel nga këtu që mos të ketë përdorim të armeve të zjarrit, përdorim të mjeteve piroteknike të jetë i kujdesshëm që mos të kemi të lënduar, ndërsa ju siguroj që saherë që kemi informata për përdorim të armës së zjarrit, kudo qoftë, ne aty reagojmë dhe hapim rast dhe zakonisht e bëjmë konfiskimin e armës. Ju falënderoj për vëmendje, jam këtu ende për pyetje shtesë.

z.Rasim Terziqi: Përshëndetje për të gjithë! Pyetje, çka keni bë ju si komand, përshembull që ne stacionin policor në Pozharan në ndërrimin e natës funksionojnë vetëm dy polic.

z.Afrim Halili, komandant i Stacionit Policor në Viti: Si nënstation, Pozharani mbulohet 24 orë me patrullë policore për shkaqe ekonomizimi, e për shkak se kemi resurs të kufizuara, ne e kemi bë një taktizim atje, në mënyre që të mbulohet më mirë. E kemi zvoglu atje numrin për tre oficer, mirë i japim dy patrulla gjatë ditës në Pozharan, sepse e kemi komandantin atje me një numër të oficerëve që operojnë gjatë ditës dhe i kryen të gjitha funksionet. Përveç sigurisë është edhe bashkëpunimi me qytetar, siguria në shkollë, është bashkëpunimi me komunitet, ndërsa pas dite kemi një patrullë të sigurt çdo ditë atje dhe në ndërrimin e natës e kemi edhe një patrullë që shkon kujdeset vetëm për Pozharanin, që në të kaluarën, edhe pse kemi pas numër me të madh, nuk kemi arrit ta bëjmë asnjëherë këtë, për shkak se ka pas pushime mjekësore. Kur të doni ejani informona se Pozharani është me i mbuluar se kurr me patrulla policore dhe fatmirësisht muj me thanë që Pozharani momentalisht është një zonë shumë e qet që nuk kemi pas raste në kohën e fundit as të vjedhjeve as të ndonjë lëndimi, ndonjë rast serioz nuk kemi pas kohe të gjatë.

z.Remzi Salihu: Rasteve të shpërndarjes së lëndëve narkotike, thatë që numri është 25. A ki ndonjë informatë nga gjykata se sa prej tyre janë dënu.

z.Afrim Halili, komandant i Stacionit Policor në Viti: Unë muaj me ju siguroj që janë trajtu të gjithë nga këta, nga Prokuroria dhe Gjykata, secili e ka marr dënimin në bazë të veprës dhe bazë rrethanave nuk ka raste që amnistohen ata apo lihen të pa trajtuar.

z.Ali Bajrami: Faleminderit për këto informata prej një organi që është me besueshmëri me të madhe në nivel vendi. 25 shpërndarës, e thatë është më rëndësi zanafilla. A është gjetë zanafilla e kësaj se kush i ka furnizua këta apo vetëm ka mbete të këta 25.

z.Afrim Halili, komandant i Stacionit Policor në Viti: Unë ju siguroj se nuk kanë përfunduar aty hetimet, nuk janë vetëm policia e Vitisë që punon në këtë fushë, po i kemi njësitë e specializuara të cilat merren edhe me atë përtej atij shpërndarësi përtej atij dënimi që e jep gjykata me vëzhgim me hetim tutje tana kanalet e ndryshme.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka pyetje tjera, të falënderojmë komandant.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi:

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dhjetë e KK-së

z.Remzi Salihu: Unë kam dy vërejtje në faqen nr.3 dhe faqen 12, në faqen nr. 3, rreshti i shtatë pas presjes, kot kur dimë që e kemi shtrirjen e rrjetit. Unë këtu kam thanë që kur dimë që rrjeti është i shtrirë që në kohën e qeverisjes se ish kryetarit z.Nexhmedin Arifi. Nëse i ka pengua dikujt me thanë z.Nexhmedin Arifi, po pajtohem edhe unë, po së paku ta kishe shtu që rrejtja ekziston për afërsisht që 8 vite. Dhe në faqen nr. 12, këtu në fillim ku thamë që nuk ka qenë dashur të sjellet në rend dite një pikë. Këtu nuk figuron fare emri im, e paraprakisht është emri i Taulantit, mirëpo kryesuesi këtu ka përfunduar dhe ka fillu fjala ime pa emër. Nuk e di qysh ka ndodhe kjo.

znj.Mirlinda Sadiku: Në faqen nr. 1, asnjëherë nuk është ndërmarr asgjë për këto tri, ka mete vetëm tre. E unë kam thanë tri vite. Edhe këtu kam thanë që Drejtoria e Inspeksionit ka urdhëru. Ju nuk e keni shkru hiq që të marr diçka në drejtim DKA-ja. D.m.th mungojnë këto dy fjali.

Kryesuesi z.Naim Pira: Me këto vërejtje e qes ne votim për miratim procesverbalin. Nga të gjithë miratohet procesverbali.

Si pikë të tretë kemi:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndërrimin e destinimit të parcelave të propozuara me nr.2582-6 dhe nr. 2582-8 nga shfrytëzimi aktual tokë tjetër - jo pjellore në rrugë publik

Drejtoresha znj.Majlina Ostrogllava: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Me këtë propozim vendim propozohet të behet ndërrimin e destinimit të parcelave të propozuara me nr.2582-6 me sipërfaqe 69 m² dhe nr. 2582-8, me sipërfaqe 34m², në zonën katastrale në Viti, të cilat janë në pronësi të Komunës së Vitisë nga gjendja aktuale, nga shfrytëzimi aktual tokë tjetër - jo pjellore në rrugë publike. Materialin e keni marr me kohë, për pyetjet shitesë jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në votim për miratim. Me dy abstenime dhe tjerat pro, u miratu kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të katërt kemi:

4. Propozim vendim për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim Kompanisë për distribuim dhe furnizim me Energji Elektrike (KEDS), pa procedurë konkurrimi

Drejtoresha znj.Majlina Ostrogllava: E kemi një kërkesë nga fshati Gërmovë, për vendosjen e një trafo. Materialin e keni marr me kohë, për pyetje shitesë jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për diskutim e qes në votim për miratim. Me votat e të gjithëve, konstatoj që u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të pestë kemi:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Planin e punës së KKS-së për vitin 2020

znj.Ibadete Hyseni, zyrtare për barazi gjinore: Në bashkëpunim me anëtarët e KKS-së kemi hartuar draft planin e punës së KKS-së për vitin 2020, i cili plan përfshinë 26 objektiva, ku janë përcaktuar edhe aktivitetet për realizimin e këtyre objektivave, aktivitetet këto të cilat kontribuojnë në çështjen e sigurisë. Nëse keni pyetje, urdhëroni!

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë.

z.Nijazi Isaku: Në këtë draft plan janë parapa objektivat, aktivitetet. Ky plan paska një kosto financiare prej 206 mijë euro. Po shpresoj që së paku këto mjete financiare të ndikojnë në përmasimin e jetës së qytetarëve e jo të ndonjë kompanie të caktuar. Kemi caktua disa objektiva për vitin 2020. Unë i kam nxjerr disa, si ulja e nivelit të krimit dhe konflikteve ndërmjet grupeve të ndryshme. Si pyetje, për cilat grupe bëhet fjalë? E ki objektivin numër 5. Tani objektivin tjetër, policia në bashkësi. A ka ndonjë raport nga policia në bashkësi? Nëse ka, cilat janë rezultatet. Objektivi tjetër janë shkollat. U diskutu kjo me herët, po a ka ndonjë rekomandim për vitin 2019 nga ky komisioni, për sigurinë në shkolla. Objektivi tjetër është zgjedhja e problematikes së qenve endacak që u ngrit me parë, por nuk keni parapa masa konkrete të zgjedhjes së kësaj çështje. Në të njëjtën kohe nuk keni parapa pas kosto buxhetore për këtë çështje, ku së paku të planifikohet ku e keni cek, së paku do të planifikohet në vazhdim për arsye se nuk ka ide se si do të duhet të trajtohet kjo çështje nëse nuk keni parapa mjete financiare për këtë problem të madh për qytetarët. Objektivi tjetër sensibilizimi i të rive. E diskutuam këtë për çështje me herët. Objektivi tjetër me të parandalimi dhe luftimi i prerjes së drunjtëve edhe këtë e diskutuam. Po cilat masa kanë mu ndërmarr, sepse nuk i pash masat në këtë objektiv për vitin 2020, edhe pse si plan është në letër mbetet mu pa vitin e ardhshëm.

znj.Mirlinda Sadiku: Ibadeten e përgëzoj për punën e bërë. Këtë herë ka qit edhe koston financiare. Po kërkojmë sqarim tek objektiva nr. 16 tek vetdijësimi i të rive nga mbrojtja nga trafikimi me qenie njerëzore. Po isha ndal të kjo e fundit, varësia nga mediat elektronike, pasi që jam kujdestare e një klase, shpeshherë problemet zanafillën e kanë pikërisht nga rrjetet sociale. Këtu i keni parapa si masë të mbrohen nga dukurit negative. A keni mendu me bë fushatë vetëdijësuese, që ndonjë ekspert i kësaj lëmie me ligjeru tek nxënësit, sepse ka shumë probleme, që pikërisht aty e kanë zanafillën, dhe me gjithë respektin, me qenë se vjen nga fusha e juridikut dhe

i njeh më mirë se unë, e kemi objektivin nr. 22, ndërmarrja e masave rreth dhënies së lejeve të ushtrimit të veprimtarisë së lojërave të fatit. Me sa e di unë, kjo u heq, u anuloi nga qeveria. A është e tepërt këtu apo duhet të hiqet krejt.

z.Bekim Azizi: Te siguria e nxënësve. Këtu ku është parapa patrullimi i procesit mësimorë, d.m.th gjatë kohës kur nxënësit shkojnë në shkollë, p.sh.: 7 e 30 minuta, është parapa edhe koha e mesditës 12:00-13:00 dhe është parapa 18:00-19:00. Këtu në ora 19:00 nuk ka nxënës, mirëpo duhet të parashihet të ndryshohet, të bëhet 17:30 përfundon ora e pestë dhe deri në ora 18:00 është ajo dendësia me e madhe e nxënësve këtu në Viti, që ajo do të jetë pjesa e kohës. Dhe te pika 22, ku është parapa edhe ushtrimi i veprimtarisë së lojërave të fatit. Tash me ligj janë të ndalume, e këtu parashihen të përmbahet rregullorja. Unë mendoj që këto këtu nuk kanë vend, e nuk pash asgjë këtu për zhurmën që është nëpër lokale të natës edhe në Viti ka shumë familje që për shkak të zhurmës në lokale e kanë problem të rrinë në banesa të veta.

znj.Ibadete Hyseni: Në këtë plan është përcaktuar edhe buxheti nga buxheti komunal, qeveritar dhe donatorët e ndryshëm. Shumicën e realizimit të objektivave do të financoj edhe Ministria e Punëve të Brendshme. Sa i përket aktiviteteve kundër dukurive negative, gjitha këto aktivitete janë plane operative të policisë nga ekipet e specializuara, siç janë ekipet e specializuara kundër narkotikëve, kundër trafikimit me qenie njerëzore, objektiva e cila është caktuar për lojërat e fatit. Ajo është masë e pezullime që mund të hiqet nga ky plan edhe pse nuk dihet se deri kur është e pezullime. Sa i përket rehabilitimit personave me të meta mendore, këtë e kemi mëndu, që këta persona të rehabilitohen në qendrën e rehabilitimit në Gjilan.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, e qes në votim për miratim. Konstatohet që me votat e të gjithëve, u miratu kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të gjashtë rendit të ditës kemi:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Planin e punës së zyrtares për Barazi Gjinore

znj.Ibadete Hyseni, zyrtare për barazi gjinore: Kemi përgatit planin e punës së Zyrës për Barazi Gjinore për vitin 2020, i cili plan është harmonizuar me programin e Kosovës për barazi gjinore si dhe strategjitë tjera nacionale ndërsektoriale, siç është strategjia e arsimit, shëndetësisë, bujqësisë etj. Në paketë plan janë përcaktuar dy objektiva, gjithëpërfshirja e barazisë gjinore në të gjithë sistemin si dhe promovimi i vlerave gjinore dhe luftimi i stereotipave gjinore, ku për realizimin e këtyre objektivave janë caktuar aktivitetet të ndryshme në të gjitha fushat, bartësit e aktiviteteve apo partnerët të ndihmojnë në implementimin e këtyre aktiviteteve. Afati kohorë si dhe një kosto buxhetore. Nëse keni propozime janë të mirëseardhura.

Kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira: Hapim debat rreth këtyre pikave të rendit të ditës.

znj.Mirlinda Sadiku: E di që në kuadër të kuvendit komunal ekziston komiteti për barazi gjinore, a e ka dhënë kontributin a hala nuk është konsultu që do ta kishte ndihmu shumë mu bë qejfi që është e shkrume në letër edhe kosto financiare, e sa do të përkrahet mbetet mu vërejt. Te pika e parë, analiza dhe vlerësimi i kostos financiare për subvencionimin e pagesës, edukim parashkollor për fëmijët që janë me skema sociale. Këtu d.m.th kosto financiare, ndërsa te buxheti i nevojshëm ka thanë nuk ka kosto. Vlerësimi është i finalizuar, atëherë nuk është bolla e kuartit nëse është finalizuar vlerësimi. Sa është këtu keni parapa realizim të emisioneve televizive, shkrimeve me rrëfime të suksesshme të femrave në profesione teknike. Unë kisha sugjeru, pasi që barazia gjinore nënkupton edhe për gjininë mashkullore jo vetëm për femërorë. Kur dërgoni p.sh.: nxënës të gjinisë femërore, ju kisha këshillu të merrni edhe nxënës nga shkolla e mesme profesionale, ku fatmirësisht dy nxënës i kanë kalu tash të gjitha testet në mesin e ma shumë se 20 komunave edhe shpresojmë për me bë kontratë për vend pune me kompaninë KEDS. D.m.th nuk është një e arritur e vogël, ku një nxënës me shkollë të mesme arrij të krijoj vend pune për vetveten. Kur keni mëndu këtu rrjetëzimi i bizneseve në pronësi të grave, vizitat studimore nëpër komuna të ndryshme. Ma merr mendja që kostoja për këtë buxhet është e ultë, një autobus nuk vjen me 100 euro. Nëse e bënë një vizitë studimore në Krushë ose dikun tjetër, nuk të mjaftojnë këto. Ndërgjegjësimi i qytetarëve për drejtat e tyre, qasjen në shërbime, takime, broshura për shërbime komunale. A ka problem këtu p.sh.: të qasja tek I-kioski. E dimë që në Pozharan ka I-kiosk, a kanë problem qytetarët, se ka njerëz të moshave të ndryshme dhe nuk kanë mundësi me pas informacionin e caktuar. Edhe të kisha sugjerua, nëse ka hapësirë dhe mundësi tek

fushatat senzibilizuese për gra në komunitet të kanceri i gjirit. Më lejoni që të themë edhe kanceri i qafës, mitrës është një ndër vrasësit në heshtje për gjininë femërore, prandaj do të kisha sugjeru, pse jo ta kishim këtu një kosto financiare prej 200 euro. Po besoj që me saktë që është këtu në kuadër të Qendrës së Mjekësisë Familjare këtu në Viti me një mbështetje me një kompjuterët ose llap top dhe një projektor pse mos të shkohet në fshatrat e larta, ta zam Debulldehun. Të keni parasysh që të jetë edhe kanceri i qafës së mitrës, më bëhet shumë qejfi që më 8 Mars, Zyra për Barazi Gjimore keni parapa tryezë lidhur me avancimin, sa po avancohen të drejtat.

znj.Ibadete Hyseni, zyrtare për barazi gjimore: Te analiza dhe vlerësimi i koston financiare për subvencionimin e pagesave të fëmijëve që janë me skema sociale, nuk kemi parapa kosto financiare, pasi që këtë e bën Drejtoria e Arsimit të rezultatet e pritshme, të jetë vlerësimi i finalizuar i kësaj kosto të cilën e kemi parapa në muajin Qershor, ndërsa të promovimi i shëndetit, këto objektiva i ka përcaktuar Drejtoria e Shëndetësisë si aktivitete dhe buxhetin. Sa i përket vizitave të grave ndermarrëse nëpër komunitat tjera, e kemi parapa koston 100 euro, mirëpo mund ta rrisim e pranojmë këtë propozim.

Kryesuesi z.Naim Pira: Unë e qes në votim për miratim, me këto propozimet që u dhanë. Konstatoj që me votat e të gjithëve, u miratu kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të shtat rendit të ditës kemi

7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Planin komunal për Integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019-2022

z.Sami Demelezi zyrtar komunal: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Draft plani komunal për Integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019-2022. Në trajnimin që e kemi pas po thuaja se për të gjitha komunitat e Kosovës është bërë një harmonizim në masën 90-95% që të jetë i njëjta, në veçanti është punu që të kenë harmonizim me komunitat që e përfshinë regjionin e Gjilanit. Materialin e keni pranuar me kohë, për pyetjet shitesë jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

znj.Mirlinda Sadiku: Këtu është një plan po nuk po shoh edhe koston financiare unë isha nal te pika 2.2 sigurimi i shtëpive të komuniteteve për strehimin e personave të moshuar pa përkujdesje familjare, e keni paraqitë si objektiv. Është evidente se shumë gjysh dhe gjyshër po mbesin në vend. Ne si komunë me sa e di unë në fillim të këtij viti, nëse nuk gaboj, atje dikun ka Letnica e kemi dhënë një hapësirë për mu ndërtu një shtëpi e komunitetit. Po ju si institucion, në bashkëpunim me ministrit e linjës a keni avoku për këtë çështje, sepse vetëm po nisem prej mahalles temë, për nja pesë familjar janë pleq e plaka që kanë mbet pa përkujdesje. Ka njerëz që janë edhe me karrocën e hendikepume. Është një çështje që brengosëse, që këta njerëz po na mbesin pa përkujdesje. Çka do të bëjë institucioni, komuna për me ju ofru këtyre njerëzve, qoftë qëndrim ditorë ose me qëndru krejt aty. Është një problem shqetësues, që as ne si shoqëri, si komunë dhe si shtet nuk jemi tu marr me këtë kategori të njerëzve, sepse familjarët e tyre po detyrohen me dal jashtë dhe normal që po mbesim pa përkujdesje institucionale dhe familjare. Një çështje tjetër që kisha pyet është personat që po riatdhesohen. Ju e dini e kam pas një rast e kam diskutu me juve, çka keni bërë ju si komunë me ofru trajnime specifike adekuate që diplomat të cilat ju lëshohen të jen relevante nëse ai mendon prapë me dal botën e jashtme.

z.Sami Demelezi: Objektivat që janë paraqit këtu janë paraqit edhe në kuadër të të gjithë komunave të Kosovës. Paramendohe diçka në rast se përmirësohet jeta në Kosovë, përndryshe ato jesis vetëm në letër. Për momentin ka qenë qendra strehimore. Ajo ka qenë në një gjendje që ka qenë mjerim me shku aty, prandaj nuk kam përgjigje tjetër. Sa i përket diplomave që merren në qendrën e arsimit profesional në Gjilan që është, janë prioritetet për ata që i marrin në fushatë, ku ata diplomohen. Po tregu është çfarë është në Vitit e ne Kosovë, prandaj edhe ajo mbetet më shumë si dëshirë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka të tjer për diskutim qes në votim për miratim edhe kete plan nga të gjith të pranishmit u miratu edhe kjo pike e rendit të ditës.

Si pikë të tetë të rendit të ditës kemi:

8. Informatë (Raport) për zbatimin e Planit të Integritetit për Komunën e Vitisë

z.Bekim Azizi: Pasi që nuk është as një drejtor këtu prezent, unë kërkoj që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën tjetër.

znj.Ibadete Hyseni, zyrtare për barazi gjinore: Në raportin që po e prezantojmë, janë marr një sër veprimesh në fushat e rrezikut që kanë qenë të identifikuar në Planin e integritetit për vitin 2017-2020, veprimet të cilat janë ndërmarr janë nën menaxhimin financiar dhe regjistrimi i menaxhimit të aseteve, menaxhimin me burimet njerëzore, inspektim, gjeodezi pronë e kadastër, shëndetësi dhe mirëqenie sociale, bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, shërbime publike dhe gatishmëri emergjente si dhe komunikim me aktorët e jashtëm. Për këto masa që janë ndërmarr, besoj që ju e keni raportin, drejtorët përgjigjen me shkrim, pasi që nuk janë këtu.

znj.Mirlinda Sadiku: Po vërehet qeverisja brilante, ku i kemi drejtorat me intereson, pse nuk është përfshi ne këtë plan të integritetit edhe Drejtoria Komunale e Arsimit, kur e dimë që është drejtoria e cila ka më së tepërmi punëtor, 825 punëtor. Unë nuk e pash që është përfshi këtu. E kemi te zbatimi i sanksioneve për mos përmbushjen e obligimit, për mos pagesën e taksave dhe tarifave. Sa janë marr parasysh rekomandimet e auditorit, p.sh.: tek mos përmbushja e obligimeve për pagesën e taksave, a është zbaruar plotësisht rregullorja për procedurat e rekrutimit. Ne si LVV shpeshherë kemi reagu me plotë të drejtë për shkelje të procedurave. Këtu po thotë është hap një link i veçantë për wep faqen zyrtare, për ankesat që kanë të bëjnë me rekrutim. Unë nuk e kam has, se boll shumë e shikoj, po nuk e kam has a është menaxhuar me sukses kontrolli i udhëtimeve zyrtare, është rrit profesionalizmi i stafit. Sa i përket teknikave të veçanta, çka keni nënkuptu për drejtorin e inspeksionit, është rritja e profesionalizmit të stafin. Sa i përket teknikave të veçanta, nuk e kuptoj për çfarë teknika të veçanta është fjala. Është realizu me sukses plani i inspeksionit, a neve në fund na vinë pasqyrat financiare me 400 euro. Edhe një planifikim i vogël, po edhe realizimi kanjëher as qeto 400 sun i mbledhim. Janë rritur fondet në shëndetësi. Më intereson ta di si janë rrit këto fonde, ku janë ato fonde dhe si ndahen. Është zbatuar ne përpikëri rregullorja për ndarjen e subvencioneve te mirëqenia sociale. Te shërbimet publike gatishmëria emergjente, janë rrit kapacitetet e stafit të përfshirë në hartimin e projekteve, kjo përmes trajnimeve adekuate, po d.m.th është shtu stafi për hartim të projekteve, po prapë se prapë projektet e juaja nuk po zgjasin shumë. Unë nuk po du mu nis prej kësaj salle po e vlerëson dikushë tjetër, po na kemi pru plotë foto këtu ku asfalti nuk zgjatë as sa afati i çokolatave si që e ka than Taulanti, ku prapë se prapë ka kërkesa për aneks kontrata, për para shtesë edhe prapë projektet nuk po bëhen ashtu si që duhet.

z.Bekim Azizi: Edhe pse kërkoja me shty, kjo pikë edhe pse nuk po kemi me kanë me debat. Tash ne nivel të gjerë është zbatimi i planit të veprimi kundër korrupsionit. Çka është ndërmarr këtu është mirë me naj pru me shkrim çka është ndërmarr, kur e dimi që korrupsioni në Viti është, taman po shifet salla këtu se sa është korrupsioni në Viti, shifen ndërtimet pa leje, çdo ndërtesë pa leje ka shku në ekstrem deri katër pesë kate jan qu më shumë. Ndoshta edhe prej drejtorit te juaj që është drejtor që e ka pesë kat pa leje, korrupsioni i kalon të gjitha nivelet, vetëm keshyrni ndërtimet pa leje e shiheni. Cili është plani që është zbatu këtu. Po thuhet që është zbatu plotësisht rregullorja për procedurat e rekrutimit të punëtorëve. A e dini bre që edhe punëtorët në shkollën e Verbanit, kur e keni qu në pushim të leonis keni shku e keni marr punëtoren që ka shku në pushim të leonisë para saj, që ka lind para saj, edhe atë e keni marr bazë të kësaj rregullore që po thuani ju. Te Drejtoria e Bujqësisë, pse bre nuk e shkruani këtu që edhe drutë që ja keni zanë fukarave nëpër mal që e kanë shkatrru këtë mal e kanë sakatu me shumtar e me krejt edhe qata dru që e keni marr i keni shit që edhe gjykata i ka dënu. Shkruni edhe ato në këtë plan.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Mu me vjen keq që e traumatizuat kaq shume mungesën e drejtorëve, sa me bë një far skeme që patet me bë pyetje e nuk janë ata këtu. Në radhë të parë planin e integritetit duhet ta kuptojmë se këtë plan nuk e kanë bë drejtorët, këtë e ka bë një grup i madh i cili ka qenë i përkrahur nga UENDP-ja, të cilët janë shku me një trajnim dy ditorë apo punëtori pune dhe janë bë përgatitjet, dhe në kuadër të ati plani që është shikohet edhe çështja e implementimit të tij, të cilin e keni aprovu ju. Pyetja e parë ishte zbatimi i sanksioneve. Çfarë sanksione keni bë, kur auditori jav ka dhanë të gjeturat. Na e kemi pas edhe planin e veprimet se si kemi me vepru për të gjeturat dhe krejt ato të cilat unë konsideroj se dülëm jashtë seriozitetit te temës për

të cilën e kemi në debat. Një pyetje, ishte a keni kontroll të udhëtimit zyrtar, nuk ka udhëtim zyrtar pa ftesë. Nëse ke ndonjë vërejtje të ndonjë udhëtimit zyrtar, thuaje cili udhëtim për ty është jashtë normave. Është rrit fondi për shëndetësi. Po ju i keni pas edhe pasqyrat, jeni aprovues të buxhetit dhe ti po pyet se në çfarë forme janë rrit. Aprovues të buxhetit jeni kanë ju, ndërsa ne propozues. Është zbatu tërësisht rregullorja për rekrutim në këtë formë e ka dhënë Zyra e Personelit. Ndërsa Bekimi e shtroj, se personeli arsimor nuk rekrutohen bazë të Ligji mbi Shërbimin Civil jan të ndara. Rregullorja për rekrutimi për stafin civil është zbatu. Pse po e thamë këtë ketu, i ke edhe mekanizmat në rast që nuk është zbatu i ki edhe komisionet, komisionin disiplinor e ki edhe komisioni e ankesave, e ki edhe shkallen tjetër qeveritar që vepron, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës. Aty ku konstatohet që nuk është zbatu rregullorja, pala e cila është e pakënaqur e ka të drejtën e ankesës edhe neve na ka ndodh naj herë mu kthy vendimi, ama rregullorja është zbatu. A është zbatu mire a janë marr të gjitha hapat, ajo është çështje tjetër, po mu zbatu është zbatu. Zbatin të planit të veprimit kundër korrupsionit, është formu një komision, është edhe plani, tash nuk guxoj unë më thanë sikur ti që po thu, sepse ti je opozitë, vetëm një çështje unë nuk pajtoj me këtë që po e thu ti, sepse po të ishte qashtu, sot kjo seancë është përmes mjeteve elektronike. Janë dy çështje këtu, ja duhet me shku ti në përgjegjësi ja unë, nëse jam i korruptum. Ti nëse ke argumente se Hasan Aliu është një prej njerëzve të korruptuar në këtë çështje shume normale, duhet mu përgatit unë e me hecë, po nëse ti e ki thanë një jo të vërtetë pa fakte dhe argumente, tani banvaki që të nalin ty. Po një kryetar i një partie me thanë këtë, në rast që nuk ki argumente, është keq, e nëse i ki argumentet, janë organet.

Si pikë të nënte të rendit të ditës kemi:

9. Raport analitik i buxhetimit të përgjithshëm gjinor për vitin 2019 dhe planifikimi për vitin 2020

z.Berat Zuka: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Raporti analitik i buxhetimit gjinor, vitin e kaluar në nëntori ka kalu si një dokument komunal, mirëpo është panevoja, sepse në qarkoren e par buxhetore që ka qenë e domosdoshme të përgatitet korniza afatmesme buxhetore, madje në qarkoren e dytë janë bë kufijtë final të përgatitjes së draft buxhetit. Është e nevojshme që komuna të përgatit edhe tabelat e përgjithshme gjinor në këtë informatë, kemi inkorporuar tabelat me ndryshim të buxhetit të vitit 2020. Nuk kam çka të shtoj me tepër. Për pyetje shtesë jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për diskutim, ju falënderoj për kontributin e dhënë. Me kaq përfundon kjo mbledhje.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:40

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Naim Pira
